



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 17.03.2026
Numër Protokolli: 1382/2026

A.nr.241/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.241/2026, të datës 04.03.2026 të parashtruar nga grup ankuesish, ankesë kjo e cila në Këshill është e regjistruar në emër të ankuesit, B.Zh, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson *Shoqëria e Avokatëve "Klinaku&Associates" L.L.C* kundër Qendrës së Studentëve, në çështjen juridike "*Kompensim Material*" duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ***shpallet jo kompetent*** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës A.nr.241/2026, të datës 04.03.2026, të parashtruar nga ankuesit, B.Zh, M.K, I.B, N.H, A.Xh, E.M, Gj.K, I.V, M.M, S.V, L.K, Sh.A, D.S.R, Xh.K, B.A V.B, M.A, B.R, F.B, N.K, U.B, Z.J, B.A, B.K, B.A.B, A.D, Sh.R, A.B, E.Sh, A.M, S.U, G.V, E.Q, F.R, S.Sh, B.K, A.S, R.C, V.P H.G, F.K, K.S.L, A.Sh.K, Rr.F, F.K, N.B, I.T, A.F, B.Rr.B, A.A, A.H, K.T, L.M, D.Sh, E.K, P.M, F.Zh, B.J, Z.M, F.B, Sh.M, N.B, S.K.B, Sh.H, A.L, G.S, I.G, A.M, B.K, A.T, H.P, L.H.R, M.L, Z.M, N.Gj.K, Gj.H, F.B, Sh.F dhe A.K

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Qendrën e Studentëve.

A r s y e t i m

Ankuesit e përcaktuar emër për emër si në dispozitivin e këtij vendimi (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit*), më datë 04.03.2026 përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 1129/2026 të regjistruar nën shenjë A.nr.241/2026 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Qendrës së Studentëve në Universitetin e Prishtinës për mos nxjerrjen e aktit administrativ lidhur me kërkesën e datës 15.01.2026, për njohjen/rritjen e shtesës sipas përvojës së punës në pagë, sipas legjislacionit në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit **sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht sipas Akt emërimeve del se ankuesit janë të punësuar në Qendrën e Studentëve, në pozitat si në vijim: ankuesi B.ZH mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për IT dhe shërbime logjistike*; ankuesja M.K mbanë pozitën e punës *Zyrtare për Shërbime studentore*; ankuesi I.B, mbanë pozitën e punës; ankuesi N.H mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i konviktit*; ankuesi A.XH mbanë pozitën e punës *Zyrtar i pagesave të shërbimeve të studentëve*; ankuesi G.J.K, mbanë pozitën e punës *Zyrtar për shërbime studentore*; ankuesi I.V mbanë pozitën e punës *Zyrtar i pagesave dhe shërbimin e studentëve*; ankuesja M.M, mbanë pozitën e punës *Zyrtare e lartë e prokurimit*; ankuesja M.S, mbanë pozitën e punës *Asistente e Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv*; ankuesja S.V, mbanë pozitën e punës *Zyrtare e Zotimeve dhe artikujve ushqimor*; ankuesja L.K, mbanë pozitën e punës *Zyrtare e Kontrollës*; ankuesja SH.A, mbanë pozitën e punës *Zyrtare për Informim*; ankuesja D.S-R, mbanë pozitën e punës *Udhëheqëse e konviktit*; ankuesja XH.K, mbanë pozitën e punës *Zyrtare për paga dhe Shërbim të studentëve*; ankuesja B.A, mbanë pozitën e punës *Zyrtare e analitikes*; ankuesja V.B, mbanë pozitën e punës *Zyrtare e pagave dhe mëditjeve*; ankuesja M.A, mbanë pozitën e punës *Receptioniste*; ankuesja B.R, mbanë pozitën e punës *Receptioniste*; ankuesja F.D, mbanë pozitën e punës *Zyrtare e triskave të studentëve*; ankuesi N.K, mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i konviktit*; ankuesi Z.J, mbanë pozitën e punës *Zyrtar i pagesave dhe shërbimeve të studentëve*; ankuesi B.A, mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i konviktit*; ankuesi B.K, mbanë pozitën e punës *Zyrtar për studentë me banim privat*; ankuesi B.B, mbanë pozitën e punës *Drejtor i administratës dhe mbështetjes*; ankuesja A.H, mbanë pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit të Kontrollës Interne*; ankuesja SH.R, mbanë pozitën e punës *Servuese*; ankuesja A.K, mbanë pozitën e punës *Zyrtare e buxhetit dhe planifikimi*; ankuesi E.SH, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesja A.M, mbanë pozitën e punës *Zyrtare për të hyra financiare*; ankuesja S.U, mbanë pozitën e punës *Zyrtare për pagesa dhe shërbim të studentëve*; ankuesja G.V, mbanë pozitën e punës *Asistente e drejtorit*; ankuesi B.K, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesi R.C, mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i konviktit*; ankuesi V.P, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesi H.G, mbanë pozitën e punës *Zyrtarë për paga dhe shërbim të studentëve*; ankuesi F.K, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesja B.RR, mbanë pozitën e punës *Udhëheqëse e konviktit*; ankuesi L.M, mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për kulturë sport dhe rekreacion*; ankuesja D.SH, mbanë pozitën e punës *Receptioniste*; ankuesi E.K, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesja P.M, mbanë pozitën e punës *Zyrtare për inspektim*; ankuesi B.J, mbanë

pozitën e punës *Receptionist*; ankuesja Z.M, mbanë pozitën e punës *Zyrtare për shërbime studentore*; ankuesi F.B, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesi N.B, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesi SH.H, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesi G.S, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesi A.M, mbanë pozitën e punës *Zyrtar për shërbime studentore*; ankuesi A.K, mbanë pozitën e punës *Zyrtar i furnizimit*; ankuesi B.K, mbanë pozitën e punës *Punëtor në sigurim në sektorin e Sigurimit fizik të objekteve*; ankuesja A.T, mbanë pozitën e punës *Udhëheqëse e prokurimit në sektorin e prokurimit, në Drejtorin e Përgjithshme*; ankuesi H.P, mbanë pozitën e punës *Punëtor i Sigurimit në Drejtorinë për financa dhe shërbime të Përgjithshme*; ankuesja LH.R, mbanë pozitën e punës *Punëtor në sigurim në sektorin e Sigurimit fizik të objekteve*; ankuesja M.L, mbanë pozitën e punës *Punëtor në lavanderi*; ankuesja Z.M, mbanë pozitën e punës *Punëtor në lavanderi*; ankuesja N.H, mbanë pozitën e punës *Punëtor në lavanderi*; ankuesja GJ.H, mbanë pozitën e punës *Punëtor në lavanderi*; ankuesja F.B, mbanë pozitën e punës *Punëtor në lavanderi*; ankuesja SH.F, mbanë pozitën e punës *Punëtor në lavanderi*; ankuesja I.G, mbanë pozitën e punës *Zyrtare e lartë e prokurimit në sektorin e prokurimit*; ankuesi A.L, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesja S.K-B, mbanë pozitën e punës *Punëtor në sigurim në sektorin e Sigurimit fizik të objekteve*; ankuesi SH.M, mbanë pozitën e punës *Punëtor i Sigurimit në Drejtorinë për financa dhe shërbime të Përgjithshme*; ankuesi F.ZH, mbanë pozitën e punës *Shtëpiak*; ankuesja A.H, mbanë pozitën e punës *Enëlarëse*; ankuesi K.T, mbanë pozitën e punës *Mirëmbajtës i ambientit*; ankuesja A.A, mbanë pozitën e punës *Udhëheqëse e Konviktit*; ankuesi A.K, mbanë pozitën e punës *Shtëpiak*; ankuesi RR.F, mbanë pozitën e punës *Shtëpiak*; ankuesi F.K, mbanë pozitën e punës *Shtëpiak*; ankuesi N.B, mbanë pozitën e punës *Shtëpiak*; ankuesi I.T, mbanë pozitën e punës *Shtëpiak*; ankuesi A.F, mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i konviktit*; ankuesi K.L, mbanë pozitën e punës *Shtëpiak*; ankuesi A.S mbanë pozitën e punës *Shtëpiak*; ankuesi S.SH, mbanë pozitën e punës *Receptionist*; ankuesi F.R, mbanë pozitën e punës *Punëtor në lavanderi*; ankuesja E.M, mbanë pozitën e punës *Receptioniste*.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit në pikëpamje lëndore, Kolegji i Këshillit bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 5 paragrafi 1, 2, 3 dhe 5, ku është përcaktuar se: Kategoritë e zyrtares/it publik janë: **1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil**; **1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik**; **1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës**; **1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës**; dhe **1.5. Zyrtarja/i i kabinetit**. **2. Nëpunësja/i i shërbimit civil** është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunëse/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunëse/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë. **3. Nëpunësja/i i shërbimit publik** është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike; **5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës** është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike”, prandaj nga përcaktimi i pozitave të punës të përcaktuara si më lartë ndërldhur

me përcaktimet ligjore lidhur me kategoritë e zyrtarëve publik, u konstatua se pozitat që mbajnë ankuesit nuk janë pozita të nëpunësve të Shërbimit Civil, por janë Nëpunës të Shërbimit Publik dhe një pjesë Nëpunës Teknik dhe Mbështetës.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 27 paragrafi 1 dhe nenit 88 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 8 të Ligjit NR. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/1-197 për Zyrtarët publik si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, rithekson faktin së Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe Nëpunësi Teknik dhe Mbështetës kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë te Komisioni i Ankesave i themeluar nga punëdhënësi, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, andaj, pas konstatimi së ankuesit nuk kanë statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.241/2026 të datës 04.03.2026, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës konstatohet së ankuesit nuk kanë parashtuar ankesë te brendshme pranë organit të punësimit, atëherë, bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Qendrës së Studentëve.

Theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.241/2026, datë 17/03/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, Shoqëria e Avokatëve “Klinaku&Associates” L.L.C;
- Qendrës së Studentëve (Komisionit të Ankesave dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore), dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.